



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
KRYETARI

Nr. 261 / 6 Prot.

Tiranë, më 27.06.2020

V E N D I M

Nr.76, Datë 27.06.2020

MBI
AUDITIMIN FINANCIAR
TË USHTRUAR NË BASHKINË ROSKOVEC
(Për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.03.2020)

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Roskovec rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat në gjykimin profesional të audituesit konsiderohen materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar (kualifikuar) për pasqyrat financiare të vitit 2017, 2018 dhe 2019.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga Subjekti i Audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Roskovec, sipas programit të auditimit *nr. 261/1 prot., datë 02.03.2020, si dhe shkresës “Njoftim për ndryshim në programin e auditimit nr. 261/2, datë 24.04.2020”*, për periudhën 01.01.2017 deri më datën 31.03.2020.

II. Të miratoj opinionin, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare në Bashkinë Roskovec të periudhave ushtrimore të vitit 2017, 2018 dhe 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh të dokumenteve që mbështesin shumat e llogarive të pasqyrave financiare, duke bërë vlerësimin e parimeve kontabël të aplikuara, vlerësimet të bëra nga drejtuesit si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Edhe pse janë audituar dhe janë evidentuar mangësitë për pasqyrat financiare për tre vite ushtrimore, opinionin ynë fokusohet në pasqyrat financiare të vitit 2019, për arsye se në këtë vit është e reflektuar edhe situata e dy viteve të mëparshëm.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Roskovec, të standardeve mbi raportimin financiar për vitin 2019, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMF dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e **një opinionin të kualifikuar¹**. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018, duke ju referuar gjetjeve të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Janë konstatuar disa llogari të pasqyrave financiare të vitit 2019, të pa rakorduar për përmbajtjen e tyre më të dhënat e investimeve të kryera:

-Në fund të vitit 2019, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është në vlerën kontabël 57,935,499 lekë. Nga të dhënat analitike të kësaj llogarie për vitet 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet se në këtë llogari, gjenden të ngurtësuar fonde para vitit 2017 për të cilat prej disa vitesh është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë likuidimi i tyre, për 25 raste në shumën 15,703,367 lekë.

-Nga analiza e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara” për vitin 2019, konstatohet:

Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2019, është për vlerën kontabël 724,828,646 lekë e analizuar për 77 objekte të investuara. Nga këto për 30 objekte në shumën 308,085,748 lekë, janë investime në proces të kryera në vitet 2017 dhe 2018 për të cilat në vitin ushtrimor 2019, nuk janë kryer sistemime. Në këtë rast, vlera 308,085,748 lekë, përfaqëson vlerën e investimeve për objekte të përfunduara, vlerë për të cilën llogaria 231 duhet të sistemohet duke e kredituar në debi të llogarive të aktiveve të investuara.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Roskovec u konstatua se për vitet 2017, 2018 dhe 2019, është kryer inventari fizik i disa aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, të trupëzuara dhe qarkulluese, por u konstatua se procedurat për miratimin e inventarëve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, asgjësimin e tyre si dhe sistemimin e llogarive kontabël sipas rezultateve të inventarëve, janë bërë në vitin ushtrimor pasardhës.

¹ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. Kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Në këto kushte, llogaritë financiare të aktiveve, nuk paraqesin me vërtetësi gjendjen fizike të vitit ushtrimor. Konkretisht:

-Për vitin ushtrimor **2017**, janë kryer veprime për sistemimin e llogarive kontabël sipas rezultateve të inventarizimit të vitit 2016 ku për nxjerrjet jashtë përdorimit, janë pakësuar llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” për shumën 4,290,890 lekë dhe llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën 1,568,059 lekë.

-Për vitin ushtrimor **2018**, janë kryer veprime për sistemimin e llogarive kontabël sipas rezultateve të inventarizimit të vitit 2017 ku për nxjerrjet jashtë përdorimit, janë pakësuar llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” për shumën 4,526,931 lekë dhe llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën 1,177,793 lekë.

-Për vitin ushtrimor **2019**, janë kryer veprime për sistemimin e llogarive kontabël sipas rezultateve të inventarizimit të vitit 2018 ku për nxjerrjet jashtë përdorimit, janë pakësuar llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” për shumën 2,255,108 lekë dhe llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën 1,622,824 lekë, ndërkohë që nga inventarizimi i kryer në vitin 2019, janë propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit inventarë në vlerën 2,487,404 lekë, të cilat janë miratuar në vitin pasardhës.

Kjo praktikë e mos mbylljes në kohë të procedurave të inventarizimit dhe sistemimit të llogarive kontabël, është shkelje e parimit të përkatësisë, plotësisë dhe kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” Kap. II, pikat 5, 8, Kap. III, pikat 28, 30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, si dhe komisionet e inventarizimit përkatës të marrin masa për mbylljen e procedurave të inventarizimit vjetor brenda vitit ushtrimor, me qëllim që rezultatet e inventarizimit të pasqyrohen drejtë dhe në kohë në llogaritë e pasqyrave financiare që lidhen me procesin e inventarit. Për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas kuadrit rregullator në fuqi për sistemimin e llogarive kontabël, duke nxjerë në kohë aktet e nevojshme administrative.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2019, gjendja e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” është në vlerën kontabël 57,935,499 lekë. Nga të dhënat analitike të kësaj llogarie për vitet 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet se në këtë llogari, gjenden të ngurtësuara fonde para vitit 2017 për të cilat prej disa vitesh është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë likuidimi i tyre, për 25 raste në shumën 15,703,367 lekë. Në këto raste, është përmbushur afati i garancisë së punimeve prej 1 viti nga dorëzimi i objekteve të investuara. Nga njësia vendore nuk janë marrë masa për zbatimin e detyrimeve kontraktuale, duke mos u njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme.

Mos likuidimi i fondeve brenda afatit sipas kushteve të kontratës nga Drejtoria Ekonomike është në kundërshtim me kërkesat e pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizojë cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës 15,703,367 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim. Nga Titullari dhe Drejtorit ekonomik të merren masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, por duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci. Nëse ka defekte dhe mos realizime të punimeve, atëherë kjo vlerë nuk duhet të likuidohet.

Brenda datës 30.09.2020

3. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e detyrimeve kreditore për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatua se:

-Në fund të periudhave ushtrimore, kanë rezultuar detyrime të pa paguara ndaj të tretëve, ndërkohë që nuk janë përdorur të gjitha burimet financiare të vitit. Për vitet 2018 dhe 2019,

shumat e detyrimeve të pa paguara, janë më të mëdha se burimet financiare të pa përdorura që tregojnë se janë kryer shpenzime pa pasur fondet e nevojshme. Më konkretisht sipas viteve, u konstatua:

-Për vitin 2017, shuma e detyrimeve të pa paguara llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" janë 148,308 mijë lekë kurse fonde të trashëguara për vitin pasardhës, llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" janë 194,830 mijë lekë, ndërkohë që nuk janë pasqyruar detyrime kreditore në një rast për shumën 5,332 mijë lekë, vlera e situacionit të punimeve subjekti "B." SHPK.

-Për vitin 2018, shuma e detyrimeve të pa paguara llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", janë 83,686 mijë lekë kurse fonde të trashëguara për vitin pasardhës, llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" janë 57,239 mijë lekë.

-Për vitin 2019, shuma e detyrimeve të pa paguara llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", janë 148,800 mijë lekë, kurse fonde të trashëguara për vitin pasardhës, llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" janë 73,517 mijë lekë.

Një praktikë e tillë në menaxhimin e fondeve, është në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, pika 101 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kreut III, pika 28 dhe 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat për organizimin e mbajtjen e kontabilitetit sipas kërkesave ligjore duke kontabilizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve në momentin e konstatimit. Të merren masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve kreditore, në zbatim të kërkesave ligjore, në mënyrë që këto detyrime të mos mbarten nga njëri vit në tjetrin, duke krijuar vështirësi financiare për njësinë vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec, për vitet 2018 dhe 2019, ka transferuar aktive të qëndrueshme për njësitë vartëse të saj për vlerën kontabël gjithsej 125,905,277 lekë, nga të cilat në vitin 2018 në shumën 56,469,346 lekë. Sipas llogarive dhe njësive vartëse si vijon:

Për UK Roskovec në shumën 56,539,346 lekë.

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" për 56,469,346 lekë (transferuar në vitin 2018).

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune" 70,000 lekë.

Për Ndërmarrjen e Pastrim, Gjelberim dhe Mirëmbajtje Varreza në shumën 41,313,675 lekë.

-Llogaria 210 "Toka, troje, terene" për shumën 7,111,260 lekë.

-Llogaria 211 "Pyje kullota plantacione" për shumën 1,562,400 lekë.

-Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" për shumën 6,694,746 lekë.

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" për shumën 889,974 lekë.

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune" 6,711,720 lekë

-Llogaria 215 "Mjete transporti" për shumën 16,289,592 lekë.

-Llogaria 218 "Inventar ekonomik" për shumën 2,053,983 lekë.

Për Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes në shumën 28,052,256 lekë.

-Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" për shumën 478,788 lekë.

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" për shumën 9,658,536 lekë.

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune" për shumën 3,484,320 lekë.

-Llogaria 215 "Mjete transporti" për shumën 13,831,992 lekë.

-Llogaria 218 "Inventar ekonomik" për shumën 598,620 lekë.

U konstatua se procedurat e transferimit të Aktiveve nuk janë të plota, pasi në vendimet e Këshillit të Bashkisë nuk është përcaktuar vlera në lekë për çdo rast të transferimit të asetëve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" neni 54.

Nga Bashkia Roskovec dhe Njësitë vartëse, nuk janë mbajtur akte rakordimi mbi dorëzimin e objekteve që transferohen, të shoqëruara me kopje të projekteve përkatëse të dorëzuara si: planimetritë, gen-planet projektet etj., veprime dhe mosveprime në kundërshtim me UMF nr. 30,

datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pikat 26, 30, 35/b, 36 dhe 57 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, të marrin masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm teknik dhe financiar për të gjitha asetet që janë transferuar nga Bashkia Roskovec në Njësitë Vartëse. Të përcaktohen vlerat përkatëse kontabël për asetet e transferuara, si dhe të hartohen procesverbalet e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim për këto asetet. Njësitë vartëse të konfirmojnë në Bashkinë Roskovec, hyrjen në magazinë të këtyre asetëve, nëpërmjet shkresës përkatëse, bashkangjitur së cilës të jetë edhe një kopje e fletëhyrjes së aktivitetit në magazinë.

Brenda datës 31.07.2020

5. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Roskovec nuk janë marrë masat e nevojshme për mirë administrimin e të gjitha aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale. Konkretisht për llogaritë e aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2019:

Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” për 17,697,700 lekë.

Llogaria 210 “*Toka, troje, terene*” për 112,776,000 lekë.

Llogaria 211 “*Pyje kullota plantacione*” për 192,000 lekë.

Llogaria 212 “*Ndërtime konstruksione*” për 448,292,237 lekë.

Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” për 891,338,474 lekë.

Llogaria 214 “*Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune*” për 5,573,645 lekë.

-Nuk është kryer inventarizimi fizik në vitet 2017, 2018 dhe 2019 si për aktivet të cilat sipas miratimeve me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Roskovec, ashtu edhe për ato të investuara nga Bashkia.

-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.

-Nuk është bërë regjistrimi i të gjithë aktiveve në ZRPP (sot ASHK) në pronësi të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se nga 78 objekte në total, nga të cilat të kontabilizuara në debi të llogarisë 210 “*Toka troje dhe terrene*” për 16 objekte dhe të llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” për 62 objekte, janë rregjistruar në pronësi të saj 31 objekte kurse për diferencën 47 objekte, nuk është proceduar për regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë Roskovec.

Përsa më sipër, mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” I ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 12 dhe Kap. VII, neni 23, pika 14 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27 dhe 30 (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Roskovec, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, të hartohet regjistri kontabël i këtyre pronave me të gjitha të dhënat e nevojshme (vendndodhje, sipërfaqja etj.). Në vijim të këtyre veprimeve të merren masa për regjistrimin e këtyre asetëve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

Brenda datës 31.12.2020

6. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara*” për vitin 2019, konstatohet:

Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2019, është për vlerën kontabël 724,828,646 lekë e analizuar për 77 objekte të investuara. Nga këto, për 30 objekte në shumën 308,085,748 lekë, janë investime në proces të kryera në vitet 2017 dhe 2018 për të cilat në vitin ushtrimor 2019, nuk janë kryer sistemime.

Në këtë rast, vlera 308,085,748 lekë, përfaqëson vlerën e investimeve për objekte të përfunduara, vlerë për të cilën llogaria 231 duhet të sistemohet duke e kredituar në debi të llogarive të aktiveve të investuara, mos veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 –*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit*

në Sektorin Publik (Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve, të rakordojnë midis tyre për të saktësuar objektet për të cilat ka përfunduar investimi sipas kontratës të lidhura me sipërmarrësit dhe mbi bazën e këtij akti rakordimi, të kryejë veprimet e nevojshme kontabël për sistemimin e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara” duke e kredituar në debi të llogarive aktive të investuara.

Brenda datës 31.12.2020

7.Gjetje nga auditimi: Bashkia Roskovec në datën 31.12.2019 ka detyrime të prapambetura për faturat e pa likuiduara në vlerën 145,601 mijë lekë (rakorduar vlera me degën e thesarit Fier). Vlora 145,601 mijë lekë përbëhet nga detyrime për investime në vlerën 144,941 mijë lekë, detyrime për shërbime në vlerën 197 mijë lekë, detyrime për vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 462 mijë lekë.

Shkaku i detyrimeve të prapambetura është mos realizimi i të ardhurave, pasi nga vlera prej 145,601 mijë lekë pjesa që i përket FZHR ka vlerën 390 mijë lekë, ndërsa pjesa që i takon të ardhurave ka vlerën 145,211 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga njëri vit në tjetrin. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”; UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimin plotësues nr. 2 të MF, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”; UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 28-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec të analizohet situata e detyrimeve të prapambetura dhe të nxirren përgjegjësitë për këtë situatë. Të mos marrin anagazhime të reja buxhetore (shpenzime të reja), pa paguar detyrimet e prapambetura, si dhe në vazhdim të mos krijohen detyrimeve të reja të prapambetura. Kjo të realizohet duke mos marrë angazhime buxhetore, pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave sipas kronologjisë së tyre. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe planin për likuidimin e tyre.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

8. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2017-2019 konstatohen diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore. Referuar dokumentacionit të planifikimit të sektorit të taksave (për planifikimin) dhe akteve të rakordimit midis Bashkisë Roskovec dhe degës së thesarit Fier (për realizimin), të ardhurat e veta për vitin 2017, nga 329,095,841 lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 253,600,845 lekë ose në masën 77%. Për vitin 2018 planifikimi ka qenë 318,177,949 lekë dhe realizimi 189,194,000 lekë, ose në masën 59%, ndërsa për vitin 2019 planifikimi ka qenë në vlerën 513,573,405 lekë, realizimi 262,421,505 lekë, ose në masën 61%. Diferencat midis planifikimit dhe realizimit të taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2017-2019, është e pa argumentuar nga sektori përkatës, pasi nuk ka shpjegime objektive për këtë, e cila tregon për një planifikim të pa studiuar si duhet. Planifikimi në vitin 2017 është 36% më i ulët se viti 2019, ndërsa planifikimi për vitin 2018 është 39% më i ulët se viti 2019 (edhe pse për vitin 2017 dhe 2018 është më i lartë numri i bizneseve se viti 2019). Pjesën kryesore në këtë rritje e zë tarifave vendore:

Tarifa e pastrimit e cila është parashikuar në vlerën 13,742 mijë lekë, realizuar 7,888 mijë lekë, ndërkohë që për dy vitet e mëparshme 2017 dhe 2018 realizimi faktik ka qenë përkatësisht 8,640

mijë lekë dhe 8,893 mijë lekë. Pra, bazuar në realizimet e mëparshme nuk ka pasur arsye reale për rritje të planifikimit.

Gjithashtu është llogaritur tarifë nga dhënia e trojeve me qira për vitin 2018 dhe 2019 në vlerën 52,052 mijë lekë, por nga vetë rezultati i arkëtimit që është zero lekë për secilin vit, arsyetohet se ky planifikim nuk është i argumentuar. Është planifikuar tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 21,180 mijë lekë, por arkëtimi është zero lekë. Janë planifikuar për vitin 2019 të ardhura nga gjobat, zhdëmtimet në vlerën 61,681 mijë lekë, por nga të dhënat rezultojnë se për vitin 2019 nga aplikimi i gjobave nga IMTV dhe Policia Bashkiake janë pa likuiduar 206 mijë lekë, pra një vlerë e pa përfillshme në krahasim me vlerën e planifikuar.

Është planifikuar e ardhur nga shitja e trojeve në vlerën 29,006 mijë lekë, ndërkohë që ka një realizim zero leke dhe nuk ka plan për një veprimtari të tillë nga njësia vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.2, faqe 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandim: Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore si dhe nga burimet e tjera të bëhet i studiuar dhe mbi parashikime realiste. Për këtë të merren në konsideratë realizimi i të ardhurat faktike të vitit të mëparshëm, të ardhurat që do të realizohen nga arkëtimi i debitorëve (duke përjashtuar debitorët “e pa shpresë”, me afat debie mbi 18 muaj). Për burimet e parashikuara, prej të cilave deri në gjashtëmujorin e parë të vitit nuk janë realizuar të ardhura, nga Kryetari i Bashkisë duhet të rishikohet planifikimi për këto burime, duke e çuar vlerën e tyre në një vlerë realisht të pritshme e të realizueshme. Po ashtu të bëhet korigjimi edhe të shpenzimet.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin “mjaftueshëm”, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. E gjithë kjo procedurë është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Roskovec e miratuar me Vendim të Kryetares së Bashkisë me shkresën nr. 793 prot., datë 19.02.2019 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1, faqe 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Roskovec, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurojë programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në njësinë e auditit të brendshëm, dy auditues nuk janë të certifikuar dhe nuk kanë eksperiencë pune, si dhe mungon trajnimi i tyre. Realizimi i

planit të auditimeve për periudhën objekt auditimi është në nivelin 50% dhe i paargumentuar si dhe nuk janë ndërmarrë hapa për ndryshime në funksion të realizimit të misionit dhe objektivave të kësaj njësie. Në dosjet e auditimeve të kryera mungojnë: memo e planifikimit të hartuara me përlllogaritjet e vlerësimit të riskut sipas koeficientit të riskut dhe përcaktimin e madhësisë së kampionit sipas fushave të auditimit, letrat e punës së audituesve, si dhe vlerësimet e cilësisë. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitë si dhe rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe nuk i referohen konkretisht çdo gjetjeje. Auditimet e kryera për sektorët me risk të lartë si prokurimet, planifikimi e zhvillimi i territorit, menaxhimi i aseteve, sektori i bujqësisë, burimet njerëzore etj janë vetëm të karakterit përshkruar (inventarizues) nuk janë të thelluara dhe nuk ka analiza për proceset e kryera në dokumentacionet e paraqitura nëse janë në përputhje me kriteret e pranuar. Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë dhe në njësitë e vartësisë. Nuk ka program angazhimi për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 11, 20, me MAB të miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 pika 2.6 "nënpika (c) dhe pika 3.5 "kapitulli III fq34, kapitulli IV pikat 4.1.7 - 4.1.12 kapitulli IV pika 4.1.1; kapitulli VI pika 6.1 "Niveli i dokumentimit"; Kapitulli VII pika 7.1.1 dhe Dokumentet Standarte (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2, faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Roskovec, të merren masa për çertifikimin dhe trajnimin e dy audituesve të rinjë, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Të sigurohet realizimi i planit vjetor të auditimeve dhe kur është e nevojshme të kryhen ndryshime të argumentuara për realizimin e funksionit të NJAB. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësisë si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2017-2019 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 33 punonjës në nivel specialisti e lart, të cilët përpara largimit nga puna nuk kanë bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal (dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion). Nga njësia vendore nuk janë hartuar rregulla të shkruara për veprimet që duhet të kryhen nga punonjësi gjatë marrjes dhe dorëzimit e detyrës, si dhe veprimet që kryejnë strukturat e tjera të institucionit në këtë proces (Njësia e burimeve njerëzore, Financa etj.). Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e aktiveve, bazën e të dhënave, transmetimin e të dhënave të krijuara nga një punonjës te tjetri, duke krijuar vështirësi për punonjësit e rinj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13, VKM nr. 124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil, pikat 27 deri 30, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 25 "Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit" (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1, faqe 16-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Roskovec të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjes dhe

dorëzimin e detyrës. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës, të marrin të gjitha masat e nevojshme që përpara largimit nga puna, punonjësi të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit fizik dhe elektronik që ka për shkak të detyrës, si dhe të inventarit fizik në ngarkim, sipas kartelës përkatëse për këtë qëllim.

Brenda datës 31.08.2020

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËRDORIMIN E KËTYRE FONDEVE ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2017-2019, Bashkia Roskovec ka kryer pagesa për zbatimin e nëntë vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, duke shpenzuar vlerën 5,408,756 lekë e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore (për vitin 2017 është likuiduar vlera 659,384 lekë, për vitin 2018 vlera 3,312,492 lekë, për vitin 2019 vlera 1,436,880 lekë). Largimet nga puna i përkasin periudhës 2009-2015. Nuk ka vendime gjyqësore që lidhen me largime nga puna për periudhën 2017-2019. Gjithashtu për vendimet gjyqësore me objekte të tjera të ndryshme, Bashkia Roskovec për periudhën 2017-2019 ka likuiduar vlerën 55,820,616 lekë (për vitin 2017 vlera 1,200,000 lekë, për vitin 2018 vlera 26,892,400 lekë dhe për vitin 2019 vlera 27,728,216 lekë. Në vlerën e mësipërme peshën specifike më të madhe e zë zbatimi i vendimit të gjykatës me objekt “Shfuqizim vendimi, rimbursim, pagim detyrimesh”, që i përket subjektit Bankers Petroleum Albania Ltd, në vlerën 52,500,000, me çështje gjyqësore të hapur në vitin 2015. Si përfundim, efekti financiar negativ në buxhetin e njësisë vendore, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht natyrës së tyre, ka **vlerën 61,229,372 lekë**. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor nga Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1, faqe 28-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Titullar i njësisë vendore të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet dhe përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Drejtoria juridik të ndjek proceset në të gjitha shkallët e gjykimit, duke bërë edhe rekurs. Në rastet e largimeve të punonjësve nga puna, nga sektori juridik dhe titullari të zbatohen të gjitha procedurat e nevojshme të afateve të njoftimit dhe të pagesave të duhura, me qëllim që të ulët riskun e humbjes së proceseve gjyqësore. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor Titullari të nxjerr përgjegjësitë administrative, si dhe aktin që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRIKUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi Bazuar në të dhënat e sektorit të taksave dhe tarifave vendore detyrimi total për taksat dhe tarifave vendore, sipas të dhënave të këtij sektori, kanë vlerën 111,865 mijë lekë, nga të cilat 14,030 mijë lekë detyrim i taksapaguesve privat dhe 97,835 mijë lekë detyrim i taksapaguesve familjar.

Detyrimi taksapaguesve familjar, përbëhet nga vlera prej 71,360 mijë lekë për taksën e tokës bujqësore, vlera prej 26,234 mijë lekë për taksat dhe tarifave të tjera vendore dhe vlera 240 mijë lekë për debitoret e tokës bujqësore të pandarë të dhënë me qera.

Nga detyrimi i total progresiv prej 111,865 mijë lekë, vlera prej 29,510 mijë lekë i përket vitit 2019, e cila përbëhet nga:

- vlera prej 2,520 mijë lekë detyrim i taksapaguesve privat;
- vlera prej 15,692 mijë lekë detyrim i taksapaguesve familjar për taksën e tokës bujqësore;
- vlera prej 11,257 mijë lekë detyrim i taksapaguesve familjar për taksat dhe tarifatat e tjera vendore;
- vlera prej 40 mijë lekë detyrim për qiranë e tokës bujqësore.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, në fund të vitit 2019 gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 57,871,238 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar edhe subjektet debitorët për tatim taksat lokale në shumën 49,869 mijë lekë kurse diferenca për 8,001 mijë lekë janë 43 subjekte debitorë të tjerë të krijuar para vitit 2014. Nga krahasimi vlerës progresive të debitorëve prej 111,865 mijë lekë, me vlerën e kontabilizuar prej 57,871 mijë lekë, konstatohet se ka ngelur pa u pasqyruar në pasqyrat financiare vlera prej 53,994 lekë.

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijojnë mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësisia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2017-2019. Nga Bashkia Roskovec nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore, në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI, Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B2, faqe 33-38 dhe pika C, faqe 38-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për kontabilizimin e vlerës së plotë të debitorëve, duke pasqyruar në bilanc vlerën progresive të debisë për të gjithë llojet e detyrimeve. Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, *për të gjitha subjektet e private* të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet **kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

e- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifatat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit.

Brenda datës 30.09.2020

E. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Roskovec, që të analizojë dhe ndajë përgjegjësitë për të gjithë personat që bëhen me përgjegjësi nga ky auditim, mbështetur në Vendimin dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi bazën e performancës së gjithsecilit të aplikoj dhënien e masave disiplinore.

Masat disiplinore për punonjësit të cilët janë me status të nëpunësit civil të bazohen në nenit 58, “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, ndërsa për punonjësit me kontratë, në nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratës individuale të punës.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Roskovec, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R